



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 140, datë 30.09.2020

**PËR
MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE “GRANT THORNTON” SH.P.K. PËR
AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE
“WVP FUND MANAGEMENT TIRANA” SH.A. DHE TË FONDIT TË INVESTIMEVE
“WVP TOP INVEST”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 35, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe neneve 4 dhe 11, të Rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e shoqërisë audituese “Grant Thornton sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë administruese “WVP Fund Management Tirana” sh.a. dhe të fondit të investimeve “WVP Top Invest”, për vitin financiar që mbyllet më datë 31.12.2020.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE